



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komunës e Klinës

05 Nr.

Klinë,

060-34074/25
08.10.2025

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Debatit me Publikun, mbajtur më 03.09.2025, me fillim nga ora 16:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e udhëhoqi kryetari i Komunes Zenun Elezaj, ku të pranishëm ishin drejtorë të drejtorive, zyrtarë tjerë komunalë dhe qytetarë të komunës së Klinës.

RENDI I DITËS

DRAFT-PLANI BUXHETOR 2026-2028

Krytari i Komunes Zenun Elezaj : Përshëndetje për të gjithë! Mirë se keni ardhur në takim me publikun dhe faleminderit për pjesëmarrjen tuaj. Në kuadër të Planit Buxhetor, duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Rregulloren, Statutin e Komunës dhe aktet tjera nënligjore, ne jemi të obliguar të organizojmë takime që përfshijnë debatet, shqyrtimet, propozimet dhe analizat lidhur me Planin Buxhetor. Ky takim është pjesë e valës së debateve që kanë filluar në terren dhe është gjithashtu një kërkesë ligjore që në dokumentet tona investuese të përfshihen secili mjedis, secila kategori, secila OJQ, si dhe aktivitetet e të gjitha veprimtarive që veprojnë në komunën e Klinës. Prandaj, kam kënaqësinë t'ju falënderoj të gjithëve që jeni të pranishëm dhe që i jeni përgjigjur ftesës publike. Tashmë jemi më të qetë edhe për faktin se i kemi zyrtarisht të pranishëm edhe kryetarët e këshillave të fshatrave lokale, të cilët tani kanë një kuadër të qartë ligjor. Më e rëndësishmja është që të gjithë ju jeni pjesë e procesit të planifikimit, shfrytëzimit dhe shpenzimit të buxhetit për vitet e ardhshme.

Krytari i Komunes i diskuton projektet dhe zotohet se do të angazhohet në qdo fushe që do të ndikoj në permisimin e jetes së Qytetarve të Komunes si dhe shpalosë projektet për vitet e ardhshme. Në keto takime në lidhje me Draft-Plani Buxhetor përfshirë edhe ato që kryetarët e bashkësive lokale i kanë prezantuar në takimin më kryetarin. Ky takim i sotëm, pra, është në

kuadër të serisë së debateve për Draft-Plani Buxhetor për vitet 2026–2028. Mendoj se, edhe nëse ka ndonjë kërkesë apo vërejtje që nuk është thënë deri tani, është koha që të thuhet. Por kjo nuk do të thotë që dikush nuk mund të paraqesë kërkesa shtesë, me qëllim që t'i përmbledhim të gjitha propozimet dhe të kemi një orientim të përbashkët me qytetarët për projektet e këtyre viteve. Përveç këtyre debateve, dua të përmend edhe dy gjëra shumë të rëndësishme:

E para, falë përfshirjes së qytetarëve në këto debate ndër vite, komuna jonë është vlerësuar ndër më të mirat në Kosovë nga organizata DEMOS. Shumë nga projektet të përfshira në buxhetin e vitit të kaluar kanë qenë të propozuara nga vetë qytetarët, në kuadër të takimeve buxhetore. Kjo është vlerësuar në tri aspekte: si obligim ligjor, si praktikë e mirë e transparencës dhe si përfshirje e drejtpërdrejtë e qytetarëve në planifikim.

E dyta, falë transparencës dhe punës së mirë të bërë, kemi marrë raport pozitiv nga Auditori i Përgjithshëm. Jemi komuna e parë në Kosovë që kemi marrë një raport të tillë. Sipas informacioneve që kemi, vetëm 4–5 komuna pritet ta përfundojnë grantin e performancës, dhe ne aktualisht jemi komuna e vetme që e kemi përmbushur këtë kriter.

Në kuadër të këtij granti janë planifikuar 16 milionë euro për të gjitha komunat. Kjo do të thotë se në vitin e ardhshëm mund të kemi një buxhet edhe më të mirë, nëse performojmë siç duhet dhe realizojmë projektet që kemi marrë nga qytetarët dhe i kemi planifikuar në këtë buxhet.

Krytari i Komunes Zenun Elezaj : Unë e hap debatin, kush dëshiron fjalën, urdhëroni!

Binak Gashi-(fshati Gremnik): Përshëndetje për të gjithë! Si kryetar i bashkësisë lokale kërkoj investime të mëtejshme si edhe kërkojë bashkpunim me të madhe që të gjitha kërkesa dhe telashet që kanë banoret e kesaj zone të mirren parasysh,. Faleminderit shumë.

Z.Zenun Elezaj , kryetari: Faleminderit, Binak, Komunikimi dhe bashkëpunimi nuk ka munguar asnjëherë nga ana ime si dhe që gjatë këtyre viteve në qeverisje por premtojë se bashkëpunime do të jëtë më i madh.

Emin Balaj: Përshëndetje për të gjithë! Deshirojë të theksoi se deshiron që në zonën e Gllarevës të përfundojnë projektet e planifikuar me zhavore si dhe një pjesë e rruges së Caravikut të behet intervenimi në të ,ju faliminderit .

Z.Zenun Elezaj , kryetari: Faleminderit, Emin. Rruga e Caravikut hyjne nen administrimin e Ministrisë ndersa sa i perkete rruget me zhavore besoi qe do të përfundojnë shume shpejtë.

A ka dikush tjetër? Nëse jo, atëherë ju falënderoj shumë për pjesëmarrje dhe për angazhim.

Procesmbajtësi,
Drilon Morina

